



BASHKIA MIRDITË
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 1253 Prot.

Rrëshen më, 29 . 03 . 2023

INFORMACION PËR KLIMËN

DHE PRIORITETET RINORE - SIPAS SONDAZHIT, TË PYETSORIT ONLINE, NË FB.

DRJTUAR: KËSHILLIT BASHKIAK MIRDITË, NË MBLEDHJEN E DATËS 31 MARS 2023

**POTENCIALET E SEKTORIT PUBLIK DHE PRIVAT NË SHQIPËRI, PËR TË ZBUTUR NDIKIMET E
NDRYSHIMEVE KLIMATIKE.**

Shqipëria është një nga vendet më të cënuara në rajon për shkak të tendencave të ndryshimeve klimatike. Modelet e ndryshimit të motit gjatë 15 viteve të fundit po përjetohen në rajon me rritje të temperaturave, ulje të reshjeve dhe ngjarje ekstreme më të shpeshta si përmbytjet dhe thatësitat. Që nga vitet 1960, ka pasur një rritje prej gjashtë deri në tetë herë në intensitetin, kohëzgjatjen dhe numri i valëve të të nxehtit në të gjithë Mesdheun lindor. Parashikimet për klimën në vitin 2050 përfshijnë rritje të mëtejshme të temperaturës, rritje të nivelit të detit dhe më shumë reshje që bien si episode të shiut intensiv në vend të borës.

Në Shqipëri, të gjithë mund të ndiejmë se tashmë stinët e verës sonë janë më të gjata dhe më të nxehta, dhe dimrat janë më të butë dhe më të shkurtër. Bregdeti ynë po ngrohet 20% më shpejt se pjesa tjetër e globit dhe ne jemi një nga vendet më të goditura nga erozioni bregdetar në Evropë. Masat e zbutjes, përshtatjes dhe zhvillimit të qëndrueshëm të përshkruara në Raporti dyvjeçar të Përditësimit demonstroi një angazhim të vazhdueshëm nga Qeveria për përfshirjen e ndryshimeve klimatike veprim në fusha dhe sektorë kyç.

Ka një ndryshim në stinë, ndërsa gushti dikur në të kaluarën ishte muaji më i nxehtë, tani verat nisën më herët, dhe korriku ka qenë muaji më i nxehtë në dekadat e fundit. Parashikimet tregojnë një rënie të reshjeve gjatë verës. Forcimi i rrezatimit diellor raportohet të jetë rritur me 10% duke e bërë prodhimin e energjisë diellore më efikas, por gjithashtu paraqet rreziqe për shëndetin duke rritur edhe shkallën e avullimit – transpirimit.

Emetimet mesatare vjetore të Green House Gas/Gaze Serre (GHG) në Shqipëri arritën në 10.8 Mt CO₂e/vit në periudhën 2009-2016. Është më pak se gjysma e emetimeve të GHG për banor se pjesa tjetër e Evropës (EU-27). Duke iu referuar raporteve ndërkombetare rezultoi se në përgjithësi, sektorët globalë që kontribuojnë në ngrohjen më të madhe në terma afatshkurtër kohore janë burimet e dominuara nga metani, p.sh, prodhimi i energjisë (miniera, karburante fosile dhe shpërndarja), bujqësia dhe menaxhimi i mbetjeve, vihet re se:

ADRESA: SHESHI "ABAT DOÇI", RRËSHEN

- 73.2% e këtij ndikimi vjen nga prodhimi i energjisë apo aktivitete të lidhura me të;
- 18.4 % nga bujqësia, pyllëzimi dhe përdorimi i tokës;
- 5.2 % nga industritë e çimentos dhe industria kimike;
- 3.2% nga menaxhimi i mbetjeve urbane dhe trajtimi i ujërave të përdorur;

Sa i përket industrisë në Shqipëri, ajo renditet si eksportuesi i 42 të në botë, me një xhiro vjetore prej 62.5 milionë dollarë të eksportuara për vitin 2020. Ndërkohë duke krahasuar Shqipërinë me trendet botërore, ndërsa në Shqipëri shkarkimet e CO2 nga industria e çimentos janë në vlerat e 299 000 m3 (referencë viti 2014) ose 5.74 % e totalit të shkarkimeve, në botë kjo industri zë vetëm 3%.

INFORMACION, PËR PRIORITETET RINORE DHE PJËSMARRJEN E TYRE, NË ZGJEDHJE. KESHILLIT BASHKIAK

Të rinjtë janë të mirë-informuar rreth mundësive për të mësuar, fituar përvojë organizative dhe vullnetarizëm, dhe për të marrë pjesë aktivisht në jetën qytetare, sociale dhe politike .

Në të gjitha takimet konsultative që janë bërë nga keshilltaret bashkiak me të rinj kane vërejtuar se të rinjtë kanë nxjerrë në pah edhe nevojën për një komunikim më efektiv me ta në platformat e komunikimit që përdoren më së shumti prej tyre. Konceptet e komunikimit digjital me të rinjtë si për të informuar ata për mundësitë për përfshirje, vullnetarizëm apo punësim apo edhe për të krijuar rrjete të përbashkëta komunikimi mes tyre duhen rishikuar

Keshilli Bashkiak ka zhvilluar një sere sondazhesh për përfshirjen e tyre në vendimarrje dhe nxjerrjen e prioriteteve . Në takime me ta rezultoi se ata kërkojnë qendra rinore në të gjithë territorin e bashkisë dhe mundësi në nivel Njesish Administrative ,duke krijuar hapësira të përshtatshme për të rinjtë. Sigurimi i infrastrukturës për aktivitete rinore do të rriste dhe promovonte veprimtarinë rinore dhe do të siguronte një bazë për zhvillime të mëtejshme për rininë si në çështjet e ndërgjegjësimit të tyre politik, vetëshprehjes dhe promovimit të zhvillimit të punës rinore. Për këto arsye duhet mbajtur në konsideratë edhe kërkesa e tyre që I është bërë keshillit bashkiak për me shume fonde në zhvillimin ekonomik.

Keshilli bashkiak përmes kesaj fushate synon aktivizimin e të rinjve në jetën social-ekonomike të bashkisë tone, përmes informimit më të mirë të tyre për zhvillimet dhe duke i bërë ata pjesë aktive të procesve të informimit dhe pjesëmarrjes në jetën social-politike të vendit.

Mbetet sfida e Keshillit bashkiak dhe administratës së bashkisë nxjerrja e të dhënave statistikore të sakta për rininë të cilat nuk japin të dhëna vetën në rang bashkie por të zberthyer (disagreguara) për çështje të ndryshme që lidhen me rininë në nivel të njesive administrative.

Për sa me sipër , në miratimin e tavanëve buxhetore duhet të merret në konsideratë çdo kërkesë e të rinjve ,pasi vetëm kështu Ne mund të kontribuojmë për të zvogëluar largimin e tyre drejt emigracionit.

Ndërgjegjësimi i të rinjve për pjesëmarrje në zgjedhje.

Gjatë zgjedhjeve të kaluara në listat e përgatitura nga partitë politike për zgjedhjet vendore të rinjtë jo vetëm që ishin pakicë por ishin marre shume pak ne konsiderate. Keshilli bashkiak nëpërmjet këtij apeli kërkon të adresojë jo vetëm përfaqësimin e të rinjve si numër në njësitë e vetqeverisjes vendore por edhe të rinjtë në platformat e kandidatëve që do të garojnë në zgjedhjet vendore. Sot kemi problematikat e mungesës së Qendrave Rinore, ambienteve sociale dhe atyere sportive. Kjo ka ardhur për shkak të mungesës së fokusit dhe programeve të bashkise dedikuar të rinjve.

Një risi tjetër që kërkon ky apel i Keshillit sot eshte ndergjegjesimi i tyre per pjesëmarrjen e të rinjve **18 – 30 vjec** në zgjedhjet vendore. Arsyet e pjesëmarrjes dhe jo – pjesëmarrjes së tyre në këto zgjedhje dhe nivelin e përfaqësimit të tyre varet nga platformat dhe kandidatët që garojnë. Prej shume vitesh nuk janë analizuar treguesit e pjesëmarrjes. Ky fakt kërkon angazhim te te gjithë keshilltareve pasi numri i votave per tu perfshire kete vit ne keshill eshte shume me i larte se i zgjedhjeve te tjera.

Të rinjtë nën moshën 30 vjeç përfaqësojnë një të tretën e popullsisë totale në Shqipëri dhe sipas parimeve të demokracisë duhet të përfaqësonin edhe 1/3 e klasës apo vendimmarrjes politike në vend. Rinia shqiptare në raport me politikën dhe partitë shpesh është përballur me sfida nga më të ndryshmet. Partitë politike shpesh e shamngin ose e paraqesin si shtojcë në programet e tyre çështjen e rinisë, madje edhe kur përmendin punësimin e tyre si objektivi të fushatës i referohen numrave të të punësuarve jo mundësive se si do të krijohen vendet e punës.

Per sa me siper, Keshilli Bashkiak sot ben apel dhe rekomandon qe: Partitë politike duhet të prezantojnë para të rinjve dhe qytetarëve programe të shkruara dhe publike gjatë fushatës elektorale në funksion të transparencës dhe llogaridhënies vendore edhe gjatë mandateve 4 – vjecare.


Këshilli Bashkiak ne shqyrtimin e tavaneve buxhetor duhet t'i japë prioritet projekteve infrastrukturore, sportive dhe edukative që lidhen me rininë duke votuar buxhet specifik për rininë dhe duke mirepritur iniciativat nga organizatat rinore në Këshillin Bashkiak.

Keshilli Bashkiak duhet te bashkepusoje me Organizatat Rinore dhe donatorët në fushën e rinisë per te shtuar projektet dhe përpjekjet për informimin e të rinjve në lidhje me kompetencat e bashkive dhe Këshillave Bashkiake si dhe përfshirjen e tyre në vendimmarrjen, mbledhjet dhe iniciativat e Këshillit.

Hartuan raportin:

KRYETAR

Pjeter PJETRI



SEKRETAR

Gaspër TOPOLLAJ



ADRESA: SHESHI "ABAT DOÇI", RRESHEN

email:bashkia@bashkiamirdite.gov.al tel dhe fax : (00355) (0) 2162233 www.bashkiamirdite.gov.al